



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Pagat e magistratëve/ 'Ne kemi qesën tonë të buxhetit, s'po marrim nga qeset e të tjerëve', Rama: A mund të flasë kështu një gjykatës?
- 2

"Të mos humbim kohë me procedura", Kurti fton PDK-në të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Kosovës (VIDEO)
- 3

Ngërçi me pagat, Rama publikon shifrat: 'Vetë zot, vetë shkop!' Gjyqtarët paguhën 500 euro më shumë se në Greqi, duan edhe 2000 të tjera
- 4

Nafta po shitet me 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin (VIDEO)
- 5

Sherri në banesën e një gruaje në Rrogozhinë, 26-vjeçari nxjerr kallashnikovin dhe kërcënon me vrasje 35-vjeçarini! Dy të arrestuar (VIDEO)

Kronikë

Autori i tritolit në Shkodër u maskua si picajol,dyshohet për mesazh kërcënues ndaj Gëzim Bushatit! Hetohet e kaluara e tij kriminale në Gjermani

Sipas burimeve, autori i dyshuar është afruar i vetëm me një motor të përshtatur si mjet për shpërndarjen e picave. Pas hedhjes së lëndës plasëse në oborr, është larguar me shpejtësi në drejtim të paditur.

■ Shpërthim me tritol në qendër të Shkodrës, lënda plasëse e vendosur në oborrin e banesës së një 60-vjeçari (EMRI+VIDEO)



Dëmet materiale nga tritolit

Redaksia
13 Shtator, 14:56 | Përditësimi: 13 Shtator, 15:19

Share

Post






Detaje të reja janë zbuluar nga shpërthimi me lëndë plasëse, i ndodhur mbrëmjen e 12 shtatorit në qendër të Shkodrës, në oborrin e banesës së shtetasit [Mehdin Bushati](#).

Sipas burimeve, autori i dyshuar është afruar i vetëm me një motor të përshtatur si mjet për shpërndarjen e picave. Ai mbante skafandër në kokë dhe ishte maskuar si picajol. Pas hedhjes së lëndës plasëse në oborr, është larguar me shpejtësi në drejtim të paditur.

Nga shpërthimi nuk pati persona të lënduar, por vetëm dëme materiale. Në momentin e ngjarjes, Mehdi Bushati, me profesion mësues, ndodhej në banesë së bashku me bashkëshorten. Ai ka deklaruar se nuk ka dijeni për motivet e ngjarjes.



[Sh].com

LEXO EDHE:

Xhenifer Gjoni, e reja që po i jep jetë turizmit në Koman: E lumtur që babai na riktheu nga emigrimi! Jam një ndër fitueset e ‘Paketës së Maleve’

Hetuesit dyshojnë se shpërthimi mund të ketë qenë një mesazh kërcënues për vëllain e tij, [Gëzim Bushati](#), i njohur edhe me emrin [Naser Bushati](#), i cili prej vitesh jeton në Gjermani dhe, sipas burimeve, ka qenë për herë të fundit në Shqipëri rreth dy ose tre vite më parë.

Në katin e parë të ndërtesës jeton Mehdi Bushati, ndërsa kati i dytë i përket vëllait të tij. Sipas të njëjtave burime, Gëzim alias Naser Bushati rezulton i dënuar më parë në Gjermani dhe Rumani, një herë me pesë vite burg dhe një herë tjetër me dy vite.

Për shkak të problemeve që ai dyshohet se mund të ketë pasur jashtë vendit, policia po heton pistën se lënda plasëse është hedhur për t'i përcjellë një mesazh kërcënues. Dyshohet gjithashtu se personi që kreu sulmin mund të ketë qenë i paguar.

Autori nuk është identifikuar ende, ndërsa grupi hetimor po analizon pamjet e kamerave të sigurisë për të rindërtuar itinerarin e tij.

Shpërthimi ndodhi rreth orës 21:30 dhe u dëgjua fuqishëm në qendër të Shkodrës, duke shkaktuar panik te banorët dhe turistët. Vetëm pak metra larg, në sheshin përpara Bashkisë [Shkodër](#), po zhvillohej një aktivitet me muzikë dhe lojëra për fëmijët dhe familjet.

Policia, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorit, si dhe për zbardhjen e plotë të motiveve të ngjarjes.

P.J/Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: [Shkoder](#) [tritol](#) [Mehdin Bushati](#) [Gëzim Bushati](#) [Naser Bushati](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



★ LAJMET MË TË VLERËSUARA >

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

7 Shtator, 07:56

Ngërçi për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë?

Qeverisë

Magjistratëve

Nuk e di

Lajme të tjera



Shpërthim me tritol në qendër të Shkodrës, lënda plasëse e vendosur në oborrin e banesës së një 60-vjeçari (EMRI+VIDEO)

12 Shtator, 22:13



Një nga ne/ Këpucari Dritan Ceni rrëfen realitetin e trishtë: Në Shkodër i riparojnë disa herë këpucët, s'kanë mundësi ekonomike



Xhensila Nako

12 Shtator, 15:06



Rrjoll, rikthehen protestat kundër resortit të Bashkim Ulajt! Banorët përplasen me policinë: Nuk e falim tokën, stop ndërtimit




Ergys Kavaja

12 Shtator, 13:52



Tritol në derën e banesës së një 36-vjeçari në Kamëz, vetëm dëme materiale (EMRI)

12 Shtator, 09:43



Transportonte 11 emigrantë drejt Shkodrës për t'i kaluar në Mal të Zi, arrestohet 27-vjeçari! Në kërkim dy bashkëpunëtorët

11 Shtator, 13:15



'Pse më sheh', vrau bashkëmoshatarin në derën e shtëpisë, Gjykata e Shkodrës lë në burg autorin!

11 Shtator, 12:00



Pas 30 vitesh pritje, nis asfaltimi i rrugës në Domën! Fshati panoramik i Shkodrës pret t'i rikthehet zhvillimit

10 Shtator, 17:35



Shkodër/ Kërcënuan me kallash e pistoletë dy persona pas sherrit me një të mitur, 2 në kërkim

10 Shtator, 12:35



7 vatra aktive zjarri në të gjithë vendin, 10 nën monitorim! Riaktivizohen flakët në Mallakastër, ndërhyhet me helikopter

10 Shtator, 10:29




'Lëvizja e parë antikomuniste', PD përkuajton 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës! Berisha: Dëshmi se liria nuk shuhet me terror

9 Shtator, 16:47



Helmimi në Fushë Arrëz, Report Tv siguron raportin e ISHP-së: Erdhi nga uji i pijshëm



Armir Mehaj

8 Shtator, 08:58



Zjarret/ 12 vatra aktive, problematike situata në Dajt dhe malin e Tërëbunit në Pukë! Operacione nga toka dhe ajri për shuarjen e flakëve

8 Shtator, 07:23

Lajmi i fundit



"Të mos humbim kohë me procedura", Kurti fton PDK-në të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Kosovës (VIDEO)

13 Shtator, 20:07





Lajmi i fundit



'Të mos humbim kohë me procedura', Kurti fton PDK-në të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Kosovës (VIDEO)

13 Shtator, 20:07